



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDËTIT PUBLIK

Analiza epidemiologjike mujore (Pasqyra 14 Sh)


ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE MUJORE

SHKURT, 2018

Analiza epidemiologjike e sëmundshmërisë infektive bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh. Pasqyra 14-Sh plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik brenda datës 10 të çdo muaji. Në muajin mars 2018 kanë raportuar 36 rrethe.

❖ Sëmundjet diarreike

Gjatë muajit shkurt 2018 vëmë re se kemi të njëjtën incidencë të sëmundjeve diarreike për 100.000 banorë (170.5) krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shkurt 2017, incidenca 174.24. Numri i rasteve sipas çdo nozologjie për muajin shkurt 2018 duke e krahasuar me muajin shkurt 2017 paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku 1. Numri i rasteve me sëmundje diarreike, shkurt 2017 dhe 2018 të raportuara nga DRSH/DSHP-te.


Në muajin shkurt 2018 kemi dy raste të konfirmuara me tifo abdominale të raportuara nga DRSHP Tirane të cilët janë të grup-moshave të ndryshme 20-24 vjeç dhe 55-59 vjeç. Rastet janë konfirmuar nga “Laboratori i Enterobaktereve” në ISHP. Te dy rastet nuk kanë lidhje me njëri tjetrin dhe janë marre të gjitha masat nga DRSHP Tirane.

Rrethi me numrin më të madh të rasteve me Salmonelozë jotifode për muajin shkurt 2018 është Shkodra me 23 raste të konfirmuara dhe kemi vetëm një rast të konfirmuar në Berat me Salmoneloze jotifode. Te gjitha rastet janë konfirmuar në laboratorët e DRSHP të rrethit përkatës. Rastet janë të grup-moshave të ndryshme dhe vetëm një rast është nën 1 muaj.

Rastet e raportuara me Shigelozë janë në total 32 nga të cilat 28 raste janë nga Shkodra të konfirmuara dhe katër raste të cilat janë suspekt përkatësisht një nga Kruja dhe tre nga Kukësi.

Numri i toksikoinfeksioneve alimentare ne shkurt 2018 është i njëjte me numrin e rasteve ne shkurt 2017. Rrethet te cilat raportojnë raste me toksikoinfeksioneve alimentare janë Berat, Bulqizë dhe Kukës.

Gastroenteritet e paspecifikuar janë te shpërndara ne te gjitha qarqet e vendit. Duhet theksuar qe numri i larte i rasteve te raportuara me toksikoinfeksione alimentare dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë ne nivelin e disa rretheve te diagnozës se sakte klinike dhe konfirmimit te saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.




Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve sipas DRSH/DSHP-ve, shkurt 2017 dhe 2018.

❖ Zoonozat


	Shkurt (Raste 2018)	Incidenca (raste/100,000) 2018	Shkurt Raste (2017)	Incidenca (raste/100.000) 2017
Antraks (Plasje)	0	0	0	0
Brucelozë	6	0.2	4	0.1
Leptospirozë	2	0.07	2	0.07
TBc ekstrapulmonar	6	0.2	7	0.25
Rikecie	1	0.03	0	0

Tabela 1. Shpërndarja e zoonozave numri total i rasteve (Brucelozë, Antraks, Leptospirozë, Tbc ekstrapulmonar, Rikecie), në muajin Shkurt 2017 dhe 2018 te raportuara nga DRSH/DSHP-te.



Grafiku 3. Shpërndarja e zoonozave (Bruceloze, Tbc ekstrapulmonar, Leptospiroze, Rikecioze) në numër total rastesh ne muajin Shkurt 2017 dhe 2018 te raportuara nga DRSH/DSHP-te.

BRUCELOZA



Grafiku 4. Shpërndarja gjeografike e Brucelozës sipas rretheve në muajin Shkurt 2017 dhe 2018 te raportuara nga DRSH/DSHP-te.

Ne total në muajin Shkurt 2018 janë raportuar 6 raste me Brucelozë kundrejt 4 raste të raportuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rastet per muajin Shkurt 2018 janë raportuar nga rrethet Berat (1 raste), Dibër (3) Librazhd (2).

ANTRAKSI

Antraksi rezulton me 0 raste raportimi per muajin Shkurt 2018, Shkurt 2017

LEPTOSPIROZA

Në total janë raportuar 2 raste me Leptospirozë ne muajin Shkurt 2018 numër ky i njëjte si ne muajin Shkurt 2017. Ne muajin Shkurt 2018 raportohet një rast vdekje nga rrethi Durrës i moshës 65 vjeç.

TBC EKSTRAPULMNONAR


Nga te dhënat e raportuara ne muajin Shkurt 2018 rezultojnë 6 raste me TBC ekstrapulmonar rastet janë raportuar nga rrethi Tirane kundrejt 7 rasteve te raportuar ne Shkurt 2017. Rastet janë raportuar nga rrethet Durrës, Shkodër, Tirane, Fier.

Rikecie, nje rast i raportuar në Shkurt 2018 kundrejt 0 raste te raportuar ne Shkurt 2017. Rasti i raportuar i përket rrethit Tirane grupmoshës 45-59 vjeç.

❖ Sëmundjet e PKI


Fruthi:

Nga hetimi epidemiologjik rezultuan ne total për muajin shkurt 2018, 301 raste ne total te dyshuara për fruth nga te cilët 142 janë laboratorikisht të konfirmuara për Fruth (Ig M pozitiv) dhe 159 janë raste qe rezultojnë negative.




Grafiku 5 Shpërndarja e rasteve pozitive me fruth sipas ditëve, shkurt 2018.

Rastet i përkasin kryesisht moshës fëmijore, nen 1 vjeç sepse janë te pavaksinuar (doza e pare e MMR behet ne moshën 1 vjeç). Shpërndarja e rasteve pozitiv dhe negativ me fruth sipas grup-moshave paraqitet ne grafikun e mëposhtëm.



Grafiku 6 . Shperndarja e rasteve te dyshuara dhe konfirmuara per fruth sipas grup-moshave, Shkurt 2018

Shperndarja e rasteve te konfirmuara dhe te dyshuara me fruth sipas rretheve per muajin shkurt 2018 paraqitet ne grafikun e meposhtem.



Grafiku 7: Shperndarja e rasteve te dyshuara dhe konfirmuara per fruth sipas rretheve, shkurt 2018

Varicele:

Rastet me varicele hasen kryesisht ne grupmoshen pediatrike 0-14 vjec dhe ne kolektiva te mbyllura si institucionet parashkollore çerdhe kopshte dhe shkolla ne forme shpërthimesh te kufizuara.

❖ Ethe hemorragjike


Nga survejanca e bazuara ne rast, gjate periudhës Shkurt 2018 krahasuar me te njëjtën periudhe Shkurt 2017, është vene re një trend i qëndrueshëm i rasteve te dyshuara për ethe hemorragjike Kongo Krime (EHKK) dhe me Sindrom Renal (EHSR).

PERIUDHA	RASTE TE DYSHUARA	RASTE TE KONFIRMUARA
SHKURT 2017	1	0
SHKURT 2018	2	0

Pra kemi patur gjate muajit Shkurt te vitit 2018 dy raste te dyshuar, një nga rrethi i Lushnjë (73 vjeç, mashkull) dhe një rast nga rrethi i Korçe, Pojan, (48 vjeç, mashkull) dhe gjate te njëjtës periudhe ne vitin 2017 kemi patur një rast nga rrethi i Tiranës (18 vjeç, mashkull) . Te gjitha rastet kane rezultuar negative për te dy diagnozat e dyshuara EHKK dhe EHSR.

❖ Meningoencefalite

Për sa i përket rasteve te dyshuara me diagnozën Meningoencefalite, duke u mbështetur ne te dhënat e Pasqyrës 14 Sh, është vene re një trend i qëndrueshëm i hasjes se rasteve me diagnozën e meningecefaliteve, gjate periudhës Shkurt 2018 krahasuar me te njëjtën periudhe te vitit 2017. Ndërkohë, gjate te njëjtës periudhe, nuk kemi asnjë rast te raportuar te dyshuar apo te konfirmuar ne lidhje me rastet meningit viral dhe tuberkular. Theksojmë se rastet me encefalit te paspecificuar kane një rritje te lehte gjate periudhës Shkurt 2018 krahasuar me Shkurt 2017.



Grafiku 8. Totali i rasteve te dyshuara meningoencefalite gjate periudhës Shkurt 2017 dhe 2018

GR .MOSHA	<1VJEC	1-4 VJEC	5-14 VJEC	15-24 VJEC	25-44 VJEC	45-59 VJEC	60+ VJEC
RASTE	0	2	3	2	0	0	2
%	0	22.2	33.3	22.2	0	0	22.2

Tabela 2. Totali dhe përqindja e rasteve të dyshuara meningoencefalite, sipas grupmoshës gjatë periudhës Shkurt 2017 dhe 2018

Ne lidhje me totalin e meningoencefaliteve gjatë periudhës Shkurt 2017 dhe Shkurt 2018, kemi predominim të gjinisë femra në raport 5:4, me hasje në nivel më të lartë përkatësisht në grupmoshën pediatrie 1-14 vjeç dhe grupmoshën 15- 24 vjeç. Tabela. 2

Theksojmë që rastet janë raportuar dhe hetuar njëkohësisht nga DSHP, sektori epidemiologjisë, në rrethet Tirane (5 raste), Vlore (1 rast), Tepelene (1 rast), Berat (1 rast) dhe Elbasan (1 rast).


❖ Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit Shkurt 2018 janë raportuar në total 19 raste me hepatite virale akute nga të cilat 8 (42%) raste janë Hepatite virale të paspecifikuara, 7(37%) raste me Hepatit viral akut B dhe 4 (21%) rast me Hepatit virale as A as B. (tabela 3)

Periudha kohore	Hepatiti I paspecifikuar	Hepatit viral A	Hepatit viral B	Hepatit viral as A as B
Shkurt 2017	6	4	8	5
Shkurt 2018	8	0	7	4

Tabela 3. Numri në total i rasteve të raportuara me hepatite virale, shkurt 2018

Siç shihet edhe nga grafiku, në krahasim me të njëjtin muaj një vit më parë, numri i rasteve të raportuara me hepatite virale akute ka pësuar rritje për hepatitin viral të paspecifikuar. Ndërkohë këtë muaj nuk ka patur asnjë rast me hepatit viral A. Rënie e numrit vërehet për hepatitin viral B dhe as A as B.



Grafiku 9 Numri i rasteve me hepatite virale akute shkurt 2017 dhe 2018 të raportuara nga DSHP-te dhe DRSHHP.

Grupmoshat	shkurt 2017			shkurt 2018				
	Hep.i paspecifikuar	Hepatit A	Hepatit B	Hepatit asA as B	Hep.i paspecifikuar	Hepatit A	Hepatit B	Hepatit asA as B
>1 vjec					1			

1-4 vjec	1				2		
5-14 vj	2	2			3		
15-24vj				2			
25-44vj	1	1	6	2		5	2
45-59vj	2		1	1		1	1
60+vj		1	1		2	1	1

Tabela 4. Shpërndarja e rasteve sipas grupmoshës

Nga tabela 4 vihet re se rastet me Hepatit viral te paspecifikuar gjate muajit shkurt te vitit 2018 i përkasin grupmoshës pediatrike 6 (75%) raste dhe grupmoshës 60+ vjeç 2 (25%). Gjate këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast me hepatit viral A.

Persa i përket HBV , 5 (72%) raste i përkasin moshës 25-44 vjeç, 1 (14%) rast grupmoshës 45-59 vjeç dhe 1 (14%) raste grupmoshës mbi 60 vjeç. Ndërsa rastet me hepatit as A as B janë përkatësisht: 25-44 vjeç -2 (50%) rast , 45-59 vjeç -1 (25%) raste , mbi 60 vjeç -1 (25%) raste. Siç shihet rastet e raportuara me HBV dhe C janë te grupmoshës se rritur mbi 25 vjeç.

Ne grupmoshat pediatrike nuk ka asnjë rast te raportuar si për Hepatitin B ashtu edhe as A as B.

Periudha kohore	Hepatiti I paspecifikuar		Hepatit viral A		Hepatit viral B		Hepatit viral as A as B	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Shkurt 2017	3	3	3	1	3	5	4	1
Shkurt 2018	4	4			5	2	3	1

Tabela 5.Shpërndarja e rasteve me hepatite virale sipas gjinisë

Sic shihet edhe nga tabela 5,meshkujt kane numrin me te larte te rasteve me hepatite virale.

Rrethe	2017				2018			
	Hep paspec	Hepatit A	Hepatiti B	Hepatiti as A asB	Hep paspec	Hepatit A	Hepatiti B	Hepatiti as A asB
Berat		1						
Bulqize								
Delvine								
Devoll								
Diber	1		1	1	2			
Durres				1			1	1
Elbasan			1					2
Fier								
Gramsh								
Gjirokaster							1	
Has								
Kavaje								
Kolonje								
Korce								
Kruje			3	1				
Kucove							1	
Kukes					1			
Lac								
Lezhe	2				4			
Librazhd	1				1			
Lushje		3						


M.Madhe							
Mallakaster	1						
Mat							
Mirdite							
Peqin							
Permet			1				
Pogradec	1						
Puke							
Sarande							
Skrapar							
Shkoder						4	1
Tepelene			1	2			
Tirane							
Tropoje							
Vlore							

Tabela 6. Shpërndarja e rasteve sipas rretheve

Ne lidhje me shpërndarjen sipas rretheve , gjate këtij muaji Shkodra ka raportuar rastet me Hepatite virale B (4) e ndjekur nga Kucova, Durrësi dhe Gjirokastra me nga 1 rast te raportuar secila. Rrethet Durrës (1), Dibër (2) dhe Shkodër (1) kane raportuar raste me hepatit viral as A as B. Nga hetimi epidemiologjik i kryer për këto rastet rezultoi se janë raste sporadike pa lidhje epidemiologjike mes tyre. Vazhdimi i raportimit te rasteve me hepatit viral te paspecifikuar ndodh për shkak te kapaciteteve te pamjaftueshme laboratorike për diagnostikimin e tyre ne laboratorët mikrobiologjike te DSHP ne rrethet e vendit.

❖ Tuberkulozi pulmonar


Gjate periudhës Shkurt 2018, krahasuar me muajin Shkurt 2017, vihet re një ulje e numrit të rasteve të raportuara me tuberkuloz pulmonar përkatësisht nga 26 raste ne Shkurt 2017 në 14 raste në muajin Shkurt të vitit 2018. Duhet theksuar se burimi i te dhënave të muajit për te dy periudhat e krahasuara është SMBS sipas muajve përkatës. Tirana paraqet numrin me te madh te rasteve ne te dy muajt e krahasuar, përkatësisht 13 raste ne Shkurt 2017, pasuar nga Lushnja qe raporton 5 raste me TBC; ndërsa Tirana paraqet 6 raste ne muajin Shkurt 2018. Shpërndarja sipas grupmoshave ne muajin Shkurt 2018 nuk paraqet ndryshime për tu evidentuar, ndërkohë qe ne Shkurt 2017 grupmosha me e prekur është 20-24 vjeç.



Grafiku 10.: Paraqitja e totalit te rasteve (numer) me diagnozen Tuberkuloz pulmonar sipas gjinise, gjate periudhes Shkurt 2017 dhe 2018.

❖ HIV/AIDS

Survejaca e SMBS ne lidhje me diagnozën AIDS paraqet zero raste te raportuara nga rrethet përkatësisht ne muajt Shkurt 2017 dhe Shkurt 2018. Kjo për disa arsye, pasi rastet qe diagnostikohen me HIV ndiqen klinikisht pranë Shërbimit Infektiv ne QSUT, ne lidhje me këto raste është ruajtur informacioni ne mënyre konfidenciale. Sipas te dhënave te Programit Kombëtar te HIV/AIDS, gjate muajit Shkurt 2017 janë raportuar 9 raste HIV pozitive, ndërsa ne muajin Shkurt 2018 janë diagnostikuar 6 raste HIV pozitive. Shpërndarja sipas gjinisë e rasteve te muajit Shkurt 2017 paraqet 5 raste tek meshkujt dhe 4 rastet janë femra; ndërsa ne Shtator te 2018 , 3 raste janë meshkuj dhe 3 raste janë femra. Shpërndarja sipas grupmoshës tregon se grupmosha qe predominon mbetet 25-45 vjeç ne te dyja periudhat, ne Shkurt te vitit 2017 janë diagnostikuar 4 raste te grupmoshën 25-45 vjeç, 3 raste ne grupmoshën > 45 vjeç, dhe 1 rast ne grupmoshën 16-24 vjeç; Ne muajin Shkurt 2018, 5 raste i përkasin grupmoshës 25-45 vjeç dhe vetëm një rast i përket grupmoshës 16-24 vjeç.



Grafiku 11 . Raste te diagnostikuara me HIV, Shkurt 2017 dhe 2018.

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë, Programi Kombëtar i Tuberkulozit**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi, Donika Bardhi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I
SHENDETIT
PUBLIK

DEKSI